

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch



Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

OBLIGIMET E TË RINJËVE TË SOTËM MUSLIMANË

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: Furkan ISM

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PARATHËNIE 4
OBLIGIMET E SOTME TË TË RINJËVE MUSLIMANË 6
KUSH ËSHTË MUSLIMANI? 7
RINIA – PJESË E FORCËS 7
TË RINJTË BARTËS TË MESAZHEVE 8
TIPARET E SHEMBËLLTYRËS RINORE 9
SAKRIFIKIMI I ISMAILIT A.S. 9
SINQERITETI I JUSUFIT A.S. 10
KATËR OBLIGIMET E TË RINJËVE MUSLIMANË 12
KUPTIMI I DREJTË I ISLAMIT 13
SHIRKU: TË BËRIT RIVALITET ALLAHU XH.SH. 15
MEKRUHI (PUNË TE PAPËLQYESHME) 16
TË PUNUARIT ME ISLAM – OBLIGIM 25
THIRRJA NË ISLAM – OBLIGIM 30
LIDHSHMËRIA ME ISLAMIN – OBLIGIM 34

PARATHËNIE

Edhe një punim i Dr. Jusuf Kardavit, dijetarit dhe mendimtarit më të shquar të kësaj kohe, përjetoi dritën e botimit në gjuhën shqipe.

Gjithë ajo që është shkruar në këtë libërth, i është dedikuar palcës së çdo populli e cila quhet rini.

Pra, të rinjëve prej të cilëve pritet gjithçka më mirë. Por në këtë kohë të pakohë, rinia është e preokupuar me probleme të shumta të cilat kërkojnë evitim dhe zgjidhje të favorshme.

Meqë i takoj gjeneratave të reja, vendosa që me dëshirën më të madhe, të bëj përkthimin e këtij libri në të cilin trajtohen problemet e rinisë, zgjidhja e tyre duke i parashtruar vetes obligime. Kështu sadopak do të plotësohet një zbrazëtirë e madhe e literaturës së këtillë.

Koha e sotme me të gjitha mjegullat e saj helmuese po mbytë gati çdo pore të jetës shpirtërore. Ikja nga ky helm është obligim. Shpëtimi i vetëm i cili i vie si kundërhelmim është BESIMI. Ajo duhet të ekzistojë në tërë qenien shpirtërore të njeriut, sepse ai është i krijuar që të besojë. Mirëpo, në çka?!!

Në të vërtetën të cilën shumica mundohen të gjejnë, por rruga e vetme e cila shpie deri te ajo, është vetëm një rrugë. Ajo është rruga e Krijuesit të Gjithësisë, i cili e njoftoi njeriun se si mund të bëhet i kënaqur në të dy botërat. Kjo e vërtetë nuk mund të arrihet ndryshe pos me lexim, sepse vetë thirrja e parë për njohjen e Krijuesit është "LEXO".

"Lexo në emër të Zotit tënd…" është begatia e All-llahut xh.sh. mbi njeriun.

Lexo është jetë, dituri, mëshirë, paqë, mirësi, amshueshmëri…

Ajo që ndërlidhë leximin dhe plotëson gjithë atë që edhe e kërkon, është zbatimi i tyre në jetën e përditshme. Shembull, namazi si obligim të cilin duhet kryer, a nuk e edukon njeriun që të jetojë në mëshirë dhe paqë, të cilat bota e sotme më së shumti i kërkon?!!! Kurse namazi fillon me mëshirë dhe përfundon me paqe.

Pra, në gjithë atë që do të haset gjatë leximit (të cilat edhe duhet praktikuar) do të vërehet se nuk ka begati më të madhe se Islami.

Të mos përqafojmë ideologji të shthurura si pellë e vetë mendjes së njeriut të cilat dita ditës po perëndojnë. Nga këto ideologji kemi jetuar të shtypur nën thembrrat e mohuesve të All-llahut xh.sh. i cili na ka premtuar se rruga e vetme e cila të shpie në shpëtim në të dy botërat është Islami.

Ne jemi ata që me optimizëm të madhe besojmë se All-llahu xh.sh. është Mëshiruesi i vetëm i cili falë gabimet, kuptohet në qoftë se kemi vendosur t'i kthehemi rrugës së All-llahu xh.sh. me sinqeritet.

Mëshira e All-llahut qoftë mbi ne.

Përkthyesi (Rexhail Aziri)

OBLIGIMET E SOTME TË TË RINJËVE MUSLIMANË

Falënderimi i takon ALLAHUT-Zotit të botërave, kurse lutjet dhe përshëndetjet më të ndershmit prej të dërguarve – Muhammedit alejhi selam.

"O Zoti im, në zgjero gjoksin dhe më lehtëso punën time, më zgjidh nyjen gjuhës që të kuptohet fjala ime!

Taha 25-28.

O ALL-LLAH, Mësues i Ademit dhe i Irahimit: Na mëso për atë që na është e dobishme, ashtu që të përfitojmë prej saj dhe shtona diturinë!

O ZOT të falënderohemi në çdo situatë dhe të lutemi që të mos na bësh banorë të zjarrit.

Tani do të përqëndrohemi në temën, e cila ka të bëjë me obligimet e të rinjëve muslimanë në kohën e sotme. Në të vërtetë cilat jaë ato?

Koha do të përqëndrohemi në termën, e cila ka të bëjë me obligimet e të rinjëve muslimanë në kohën e sotme. Në të vërtetë cilat janë ato?

Koha në të cilën jetojmë është aq e programuar, sa që prej të rinjëve tanë kërkohet shumëçka për t'u arritur diçka. Mirëpo në rend të parë duhet të dihet mirëfilli se…

KUSH ËSHTË MUSLIMANI?

Muslimani është faktor thelëbosr i ekzistencës. Ai njëherit është edhe bartës i thirrjes së përhershme dhe trashëgimtar i profetëve të ZOTIT xh.sh. veprimtaria e të cilëve kishte pikësynim realizimin e këtij dini (kësaj feje) në sistem jete.

Të gjitha shpalljet e mëparshme që zbritën nëpër periudha të ndryshme kohore, më në fund arritën gjer në kompletimin e tërësishëm të islamit. Për këtë dëshmon ALLAHU Fuqiplotë në Kur'an, ku thotë:

"Sot ua kompletova fenë tuaj, ua plotësova dhuntinë time dhe për ju pëlqeva islamin – fe"

El Maide 3.

Muslimani është ai që përcjell këtë thirrje të Muhammedit alejhi selam-thirrjen e Kur'anit famëlartë.

RINIA – PJESË E FORCËS

Rinia përbën pjesën e forcës dhe lëvizjes më të gjallëruar, ngase është periudhë e mesme e jetës – e siç dihet mesi i çdo gjëje është më i pëlqyeshëm.

Këtë mund ta ilustrojmë edhe me diellin, i cili kur gjendet në kupën e qiellit, ka nxehtësi më të madhe.

Pra rinia si periudhë e vrullshme e jetës paraqet formën më të rëndësishme jetësore. Mu këtu qëndron edhe vlera e saj, sepse mugulion fruti më i shëndoshë i moshës. Me një fjalë rinia është bartëse e vlerave më të rëndësishme dhe flamurtare e shfrytëzimit të mundësive që ofrohen.

TË RINJTË BARTËS TË MESAZHEVE

ALLAHU, Krijuesi ynë, na tregoi mjaft mirë për shokët e Musait alejhi selam.

"Musait nuk i besonin njerëzit me perjashtim të disave, sepse frikoheshin nga faraoni dhe klika e tij"

Junus 83.

Nga Kur'ani madhështor gjithashtu mund të mësojmë edhe për banorët e shpallës:

"Ne po të tregojmë saktësisht për çështjen e tyre ata ishin djelmosha që e besuan Zotin e tyre, kurse ne edhe më shumë ua shtuam bindjen atyre".

El Kehf 13

ALLAHU Fuqiplotë na tregoi për Ibrahimin, i cili i rrëzoi të gjitha putat, përpos atij më të madhë, të cilin e la shpresë për idhujtarët. Në Kur'an aludohet në fjalët e putistëve (idhujtarëve):

“Ata thanë: kemi dëgjuar për një djalosh që quhet Ibrahim”.

eL eNBIJA 60

Ibrahimi alehji selam asokohe ishte në moshën rinore.

TIPARET E SHEMBËLLTYRËS RINORE

Kur’ani bën fjalë për një sërë të rinjësh, puna e të cilëve mbeti si shembëlltyrë më e ndritshme për brezat që vinë pas.

SAKRIFIKIMI I ISMAILIT A.S.

Kur’ani na tregoi për Ismailin se si e vuri qafën e tij në vend të caktuar dhe me dëshirë vetëmohuese pranoi të bëhej sakrificë e urdhërit të ALLAHUT xh.sh. Për hirë të ZOTIT xh.sh., vendosi që lajmit të babait t’i dal pa kurrfarë frike ballëhapur.

“O biri im, të pashë në ëndërrë se si të bëja kurban. Pres mendimin tënd. Ismaili tha. “O babi im vepro si je i urdhëruar”.

Es Safatë 102.

Ismaili alejhi selam nuk tha: "vepro me mua si je i urdhëruar", por "vepro sipas urdhërit". Nga kjo kuptojmë se atij fare nuk i interesoi faktori personal, por u përgjegj "zabto urdhërin e mos pyet për mua".

"Vepro sipas asaj që je i urdhëruar, nëse do allahu do të më gjesh në mesin e durimtarëve"

Es Safatë 102.

SINQERITETI I JUSUFIT A.S.

Kur'ani na tregoi edhe për një të ri tjetër – Jusufin alejhi selam.

Këtij iu dha rasti ta kënaq epshin e tij, por ky e refuzoi atë. Rrethana u krijua që ai t'i nënshtrohet detyrimisht kësaj sprove. Ai posedonte edhe bukuri joshëse, nuk ishet i martuar që të dronte prej shkeljes së kurorës, kurse ajo që i afrohej nuk ishte i martuar që të dronte prej shkeljes së kurorës, kurse ajo që i afrohej nuk ishte grua ee lënë pas dore, por zonjë me bukuri e pozitë mbretërore. Nga ana tjetër Jusufi ishte rob në pallatin e saj.

Përkundër kësaj ky nuk ra nën ndikimin e epshit, fal besimit të fortë që kishte. Sprova e tij nuk ishte e rastit, por brengë që e përcjellte në çdo çast-prej mëngjesit e deri në mbrëmje. Gruas provokatore nuk i mjaftonin mimikat si dhe gjestikulacionet, por edhe e konkretizoi qëllimin e saj me fjalë, duke i thënë: "Eja këtu". Jusufi e refuzoi këtë kategorikisht:

“Dhe tha: Allahu më ruajt, zotriu im (burri yt), më nderoi me vendosje të mirë (e si unë t’ia kthej me të keqe). Pamëdyshje keqbërësit nuk kanë sukses”

Jusuf 23.

Meqë u refuzua nga Jusufi alejhi selam, ajo zgjodhi metodën e kërcënimit, duke e shpallur atë para shoqeve të saj si rrugë suksesive.

“Ajo tha: ja ky është ai të cilin e deshta e më refusoi, nëse nuk epron sipas urdhërit tim do të burgoset dhe do të jetë prej të nënçmuarëve”

Jusuf 32.

“(Jusuf) tha: Zoti im, më mirë të jem në burg se pre e kurthës që po më kurdiset nga këto dhe nëse nuk e heq prej meje dredhinë e tyre, ndoshta do të anoj kah ato e do të bëhem injorant”

Jusuf 33.

Jusufi alejhi selam u gjend në mes dy drejtimeve: të zgjedhë sprovën në fe ose në jetë. E para ddo ta shtyente në zina (amoralitet) e do ta bënte blasfemues, kurse e dyta do ta fuste në burg dhe do ta bënte të nënçmuar. Mirëpo ai zgjodhi sprovën në këtë, e jo në botën tjetër.

Muhammedi alejhi selam na mësoi të themi: “O ALLAHU ynë, mos na sprovo në fe, mos na pajis me dituri të nevojshme vetëm për këtë jetë”.

Këta ishin të rinjtë e asaj kohe e ky ishte qëndrimi i tyre. Rinia gjithherë ka qenë bazë ku është ngriture fuqia e ruajtjes së këtij misioni. Shembull tipik ishin shokët e Muhammedit alejhi selam.

Ebu Bekri, i cili e pranoi islamin në moshën 38 vjeçare, Omeri dhjetë vjet më i ri dhe Aliu më i riu me 10 vjet. Njerëz të këtillë pati të moshave të ndryshme (9, 12, 13, 14, 15… vjeç), ALLAHu qoftë i kënaqur me ta.

Nisur nga ky fakt, mund të themi se të rinjtë muslimanë paraqesin faktorin më të rëndësishëm në islam. Ata gjithashtu kanë obligime të mëdha ndaj vetes, fasë të cilës i përkasin dhe popullit të tyre.

Hyrja e rinisë në binarët e kohës është kërkesë e përhershme, kurse obligimi kryesor me të cilin duhet të preokupohen ata është njohja e identitetit personal, ose ndryshe thënë ta dinë se kush janë e çka janë.

KATËR OBLIGIMET E TË RINJËVE MUSLIMANË

Këtu do të bëjmë fjalë për katër obligimet, që rëndojnë gjithnjë mbi qafën e të riut musliman, si pjesë të pandara të përditshmërisë së tij.

Cili është i pari?

KUPTIMI I DREJTË I ISLAMIT

Obligim i parë është të kuptuarit e drejtë të Islamit, ngase veprimit i paraprinë dituria. Njohja e islamit duhet të bëhet prej bazae të pastërta burimeve. Kjo vlen veçmas për të riun musliman.

Siç dihet njerëz të ndryshëm janë përpjekur që ta prishin bërthamën e shëndoshë të islamit, duke futur në të, elemente të huaja shkatërrimtare e duke hequr prej saj kthjelltësinë e vërtetë burimore.

Në këtë mënyrë shija e njëmendtë e islamit u turbullua. Madje brenda këtij dini depërtuan edhe risi, të cilat u quajtën si risi gjoja të mira, me arsyetim se "teprica e së mirës është e mirë".

Muhammedi alejhi selam tërhoqi vërejtjen për çdo tepricë në islam, se çdo gjë që pranon tepricë-pranon edhe mungesë. Përsosshmëria është e zhveshur nga teprica dhe mungesa. ALLAHU i Gjithëfuqishëm e kompletoi islamin dhe nuk pranon tepricë prej askujt.

"Sot ua kompletova fenë tuaj, ua plotësova dhuntinë time dhe për ju pëlqeva islamin-fe".

El Maide 3.

Ai që dëshiron ta plotësojë islamin me teprica të panevojshme sikur përpiqet të gjejë mungesa në atë, të cilën i Gjithëndijshmi e quajti të përsosur.

Mu për këtë Muhammedi alejhi selam na tërheq vërejtjen: "vajmedet për ata që fusin risi, sepse çdo risi shpie në humbje: Kush fut risi në islam e që nuk i përket islamit, atij nuk i pranohet (risia)"

Risitë në fe janë të papranueshme. Islami obligon pjestarin e tij që të ec nëpër binarët e sigurt të normativave fetare dhe nga ana tjetër nxit risi, por vetëm në lëmitë e jetës, ashtu që të hapërohet drejt progresit krahas me kohën.

Në jetën e ithtarëve të islamit u bë një rokadë e mbrapshtë, mu pas keqësimit të situatës së muslimanëve atëherë kur në derë trokiste prapambeturia).

Në vend se të shkohet nëpër gjurmët e përparimit modern, u shpikën aso risi (në islam), që e ngrinë gjendjen e muslimanëve brenda amullit të turbullt.

Andaj kërkojmë prej të rinjëve muslimanë që ta kuptojnë islamin rrënjësisht nga bazat e kthjellta burimore.

Sot kanë ndryshuar metodologjitë, në krahasim me ato të mëparshmet. Atëherë islamit i shtoheshin teprica në besim e ligje, kurse sot dëshirohet të pakësohet ose të hiqet nga islami baza kryesore. E tërë kjo fushatë përherë udhëhiqet prej individëve të caktuar, çka do të thotë se historia përsëritet e në skenë ndërrohen vetëm figurat.

Në këtë kohë dëshirohet islami pa ligj, pa xhihad, pa shtet ose shteti laik-i ndarë prej fesë. Dëshirohet që islami të mos jetë dënues i lavirëve, alkoolistëve dhe mëkatarëve tjerë të mëdhenj.

E tërë kjo bëhet me qëllim që islami të zhvishet prej realitetit të njëmendtë. Kjo fushatë duhet të kundërshtohet ashpër, sepse termi tepricë dhe mungesë nuk përkon assesi me islamin.

Këtë duhet ta dijë e tërë rinia islame.

Ne dëshirojmë që gjërat të vihen në vendin përkatës. Prioriteti duhet t'i jepet asaj çështje që e meriton atë, kurse për më vonë të lihet ajo që nuk kërkon zgjidhje urgjente. Ky klasifikim bëhet në këtë mënyrë sepse parimet islam nuk janë në një shkallë të njëjtë.

Besimi është themel i islamit, kurse pastaj vijnë obligimet si shtylla të tij.

Islami ndërtohet në pesë shtylla, të cilat paraqesin llojin e karakteristikave të posaçme.

Namazi është shtylla e fesë, ndërsa zekati hambar i islamik. Në këtë mënyrë edhe obligimet tjera ngërthejnë barazpeshën e vlerave të veçanta.

Islami përmbledh edhe obligime tjera që në realitet nënkuptohen si detyra të domosdoshme (fardu ajn) dhe detyra për disa (fardu kifaje).

Gjithashtu vlen të caken edhe sunetet, për të cilat Muhammedi alejhi selam shpeshherë ka tërhequr vërejtjen që të kryhen si dhe punët tjera të lavdërueshme (mustehab), prej të cilave rrjedh shpërblimi nëse kryhen e jo dënimit nëse lihen.

Nga kjo kuptojmë se në islam obligimet nuk rangohen në një shkallë të njëjtë, ashtu siç nuk rangohen edhe gjërat e ndaluara.

SHIRKU: TË BËRIT RIVALITET ALLAHU XH.SH.

Shirku ndahet në: shirkun e vogël dhe shikrun e madh.

Ndalesat në islam mund të jenë të mëdha e të vogla por edhe shkalla e tyre është ënë varësi prej peshës që kanë.

Mëkatet e vogla mund të shtyhen, duke falur pesë kohët e namazit.

Muhammedi alejhi selam ka thënë: "Pesë kohët e namazit, koha prej xhumaje në xhuma dhe ajo prej Ramazani në Ramazan janë që pastrojnë mëkatet e vogla në qoftë se shmangemi prej mëkateve të mëdha".

Mëkatet e mëdha nuk pastrohen ndryshe pos vetëm se me shprehjen e pendimit të thellë dhe duke ia kthyer njëherit hakun personave që iu është bërë dëmi.

Përpos kësaj vlen të përmenden disa gjëra të dyshimta, për të cilat mendimtarët islam ndajnë qëndrimin e tyre më dysh: disa i lejojnë e disa i ndalojnë.

Nga kjo nënkuptohet se ajo që ndalohet prej disave nuk bën pjesë në haramin e pranuar nga të gjithë.

MEKRUHI (PUNË TE PAPËLQYESHME)

Mekruhi ndahet në: mekruh tahrim (i afërt me haramin) dhe mekruh tenzih (më larg haramit).

Secila gjë klasifikohet në rangun e vet. Nuk është normale të nxitet luftë rerth një gjëje të dyshimtë (mekruh) dhe me çdo kusht të kërkohet ndalimi i saj prerazi, derisa te dietarët është ende e padefinuar mirë.

Mu për këtë shkak duhet t'u japim rëndësi gjërave kryesore në islam, e para së gjithash ndërtimit të besimit të vërtetë (në një Zot). Praktimi i obligimeve (frazeve) si pikënisje për të cilën nuk duhet të vie parasysh aspak luhatshmëria dhe largimi ose lufta ndaj mëkateve të mëdha, luajnë rol vendimtar në këtë pikëpamje.

Atëherë kur ta studiojmë islamin dhe kur ta arrijmë shkallën e kuptueshmërisë së tij në nivel të duhur mund të bëjmë edhe thirrje tek të rinjtë, që edhe ata të njihen me këtë të vërtetë. Përndryshe thirrësi duhet të disponojë njohuri reth shkallëzimit të gjërave fundamentale në islam. Ai në asnjë mënyrë nuk guxon të futet në luftë me gjëra të dorës së dytë pa qenë i vetëdishëm, sepse gjëja primare që e karakterizon jetën mbi gjithçka është lufta në mes besimit dhe mosbesimit.

Mu për këtë, kërkesë koha është që besimi në islam të nxitet nga bazat e shëndosha burimore.

Kthimi tek libri i Allahut Fuqiplotë, suneti i Muhammedit alehji selam, etk kuptimi i çiltër i veprës së sahabëve dhe pasuesve të tyre, paraqet burimin më të kthjelltë, sepse kuptueshmëria e tyre ka qenë e ndërlidhur ngushtë me kryerjen e obligimeve.

Ne duhet që të mundohemi ta kuptojmë islamin prej shkallës së parë, duke mos lejuar që në ne të ndikojnë gjrëat e dyshimta që me prapavijë janë futur në këtë din me qëllim që të turbullohet vërtetësia e tij.

S'ka dyshim se në kulturën islame kanë hyrë edhe disa gjëra të jehudëve (israillijat), hadithe të rrejshme e të dobta, si dhe mendime të errëta. E tërë kjo ishte rrjedhim i përzierjes së muslimanvëe me popujt tjerë që natyrisht përcillet me këmbimin dhe shkëmbimin e traditave reciproke.

Kjo gjë duhet të merret parasysh nga të gjithë muslimanët, me qëllim që dituria islame të thithet nga nektari i dietarëve të vërtetë.

Imam Maliku ka thënë: "Fjala e secilit njeri mund të merret e të kthehet (të vihet në peshojë), përpos fjalës së të pagabuarit, Muhammedit alejhi selam, e cila pranohet pa kurrfarë rezerve". Fjali me përmbajtje të njëjtë kanë thënë Ata dhe Abasi r.a.

Nga e gjithë ajo që shoshitëm gjatë zhvillimit të kësaj tematike nuk e patëm për qëllim që prej studentëve të lëmive të ndryshme shkencore (medicinë, ekonomi, inxhenjeri…) të kërkojmë braktisjen e drejtimeve të tyre përkatëse për t'i studiuar librat e haditheve, tefsirit etj. Studimi fetar thjesht nuk kërkohet prej çdo njeriu. Nëse dëshirohet t'i ofrohet ndihmesë islamit, kjo mund të realizohet edhe atëehrë kur individët orientohen në specializime të ndryshme dhe si kuadro të tilla kontribuojnë për islamin në të gjitha drejtimet. Kuptohet se secili zgjedh drejtimin e tij sipas mundësisë dhe dëshirës. ALLAHU xh.sh. thotë:

"Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbulli tyre të mos shkojë nga një grup pët t'u aftësuar në dituri fetare, ashtu që kur të kthehen ta mësojnë popullin e tyre të bëhen më të kuptueshëm dhe që të ruhen më shumë".

Et Tevbe 122

Dituria ndahet në disa lloje, prej të cilave shkoqisim dy sosh: dituri ku individi specializohet dhe përgatit kuadro të reja për të ardhmen, dhe dituri që kërkohet prej çdo muslimani (t'i dijë bazat e fesë, përmes të cilave do ta gjejë qëllimin e rrugës së ndritshme.

Vetëm me një armatosje të tillë njohurish, njeriu i besimit islam do ta programojë jetën me adhurim të pastër, me moral të çiltër dhe me veprim të drejtë në mes hallallit dhe haramit (të lejuarës e të ndaluarës).

I larguar prej gjërave që shtrëngojnë rreptësisht dhe nga ato që lejojnë tepër muslimani duhet t'i krijojë vetvetës së tij një pasqyrë reale të islamit edhe atë prej bazave të shëndosha.

Shtrëngimi i tepërt, dhe liria jonormale janë dy drejtime, që mund të çojnë vetëm në kuptimin e verbër të islamit.

Mjerisht pasojat e kësaj po i përjetojmë në kohën e sotme.

Është kërkesë e kohës që të rinjtë muslimanë të zgjohen dhe të bëhen shembëlltyrë në mësime, ashtu që t'i tergojnë botës anembanë se feja e tyre nuk paraqet kurrfarë pengese në studime. Mirëpo, këtu nuk bën të ngatërrohen gjrëat, në atë mënyrë që një çështje të fitojë prioritetin e tepruar, kurse tjetra të pësojë lënien e tërësishme pasdore.

Studimi dhe të arriturat në dituri janë domosdoshmëri parësore e çdo thirrësi, ndërsa shtresa tjetër populloer duhet t'i dijë gjërat elementare siç janë namazi, pastrimi para namazit, parimet e agjerimit…

Ai që do të bëhet haxhi ose shpreh dëshirë ta bëjë umren, do të duhej të lexonte ndonjë broshurë rreth detyrimeve që u paraprijnë këtyre.

I pasuri duhet të njihet me rregullat e zekatit.

Tregëtari duhet të njihet me rregullat e tregëtisë, shitblerjes, kamatës etj.

Ecuritë e përditshme të jetës, të ngrënurit, të pimurit, veshmbathja, të folurit, të dëgjuarit e kështu me radhë, duhet të koordinohen me disa njohuri elementare.

Gjithnjë vëmendjen duhet ta përqendrojmë rreth islamit, ashtu që të mos hymë në haram dhe të mos ia tërheqim dikujt vërejtjen se ka hyrë në haram, pa qenë të vetëdishëm përkitazi me atë çështje me të cilën ka të bëhet.

Po ashtu nuk bën ta quajmë mekruhin haram ose anasjelltas. Kjo gjë është me peshojë të rëndësishme në islam, sepse ky din ngrihet në saje të themeleve të arsyeshmërisë së shëndoshë, e nuk është si fetë e tjera që thonë: "beso-syqorrazi" ose "mbylli sytë dhe ecë pas gjurmeve" ose "injoranca drejt devotshmërisë".

Allahu i GJithëdijshëm prerazi thotë:

"Thuaj: kjo është rruga ime, thërras në allahun qartazi me argumentime, unë dhe ata që përcjellin fenë time"

Jusuf 108.

Secili që trason rrugën islame, thërret në ALLAHUN me argumente të qarta dhe në dritë. ALLAHU xh.sh. thotë:

“Atij që Allahu ia hapi gjoksi për pranimin e Islamit, ai është prej Zotit të tij udhëzuar ne dritën e imanit”.

Ez Zumer 22.

“A është i njëjtë ai i cili është i mbështetur në argumentet e Zotit të tij, me atë që veprat e këqija i janë bërë hijeshi”.

Muhamed 14.

“Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon kah drita e tij atë që ai don”.

En Nur 35.

Dritë e intuitës shpirtërore dhe mendore, dritë e Shpalljes - dritë mbi dritë.

Islami nuk pranon udhëtime nëpër skëterrë, ose tutoritet dhe shtegtime revane-pa fre. Ky din i pastër ua ka bërë të qartë njerëzve që ta njohin islamin vetëm përmes argumenteve, duke ua lënë njëherit lirinë që të pyesin për vërtetësinë e argumentit deri atëherë sa t’u qetësohet zemra rreth gjërave për të cilat kanë dyshuar.

Tekefundit parimi islam mëson që ligji të njihet me fakte, sepse dituria është njohja e së të vërtetës përmes argumenteve.

Detyra e çdo të riu musliman është që ta kuptojë këtë gjë fort mirë e të mos bëhet pasues i verbët i gjeneratave të mëparshme, të cilat dolën prej shkollave ku merrej dituria e përgjithshme mirë, e ajo islame pothuajse fare. Atij brezi edhe ajo që iu është servuar nga islami iu është përcjellë turbullt dhe me plot deformime. I riu hynte e dilte prej këtyre shkollave me më shumë dituri rreth

historisë evropiane se sa rreth asaj islame. Thënë troçs më tepër dinte për Napoleonin se sa për Muhammedin alejhi selam; dinte më shumë për revolucionin francez se sa për misionin e islamit.

Nga historia e Muhammedit alejhi selam dinte vetëm disa faqe të vagëlluara, ndërsa për sahabët vetëm rerth shpifjeve gjatë asaj kohe, luftës mes tyre…

Në thelb i riu i kësaj gjenerate nuk dinte rreth thirrjes së Muhammedit alejhi selam; rreth veçorive që e karakterizonin personalitetin e këtij profeti se:

a) Çka i solli Muhammedi alejhi selam botës?

b) Cilat ishin tiparet e kësaj gjenerate që u kalit me edukatën e Muhammedit alejhi selam?

c) Me çka u dallua ky brez nga të tjerët?

- Si u ngrit përparimi islam?

Kur njerëzit filluan ta adhurojnë ALLAHUN Fuqiplotë me një dashuri të sinqertë të skalitur me moralin që e ndërtoi islami, atëherë kur Perendimi ishte i zhytur në errësirën e injoracës aq sa nuk ia arrinte dot ta shikojë dritën e përparimit as përmes birës së gjilpërës.

Ky është shembull i pamohueshëm, përmes të cilit mund të flaken të gjitha dyshimet e pabaza.

Duhet pasur parasysh faktin se para se t'ua përcjellim të tjerëve islamin në rend të parë duhet ta mësojmë mirë për vete. Kështu do t'u mbyllej edhe shtegu i fundit disa personave endacakë, të cilëçt të vërtetën islame e veshin me gzofin e të pavërtetës dhe hudhin mbi këtë din të pastër rrena të dëmshme duke u orvatur në këtë mënyrë ta njollosin personalitetin e Muhammedit alejhi selam, historinë dhe popullin e tij.

Ne kemi nevojë që të jemi të pajisur me njohuri të shëndosha për dinin tonë, profeti ne fundit, Kur'anin madhështor, sheriatin e plotë në drejtësi, historinë e lavdishme, popullin shembullor dhe për kulturën tonë të përsosur nga ligji i mençurisë së shprehur.

Vetëm në këtë mënyrë mund t'i vehemi në shërbim të vërtetës islame, duke i bërë sfidë të pavërtetës nga do që të vie ajo, edhe pse jobesimtarët e urrejnë këtë.

Meqë disponojmë me fakte të vërteta argumentuese nuk bën që gjithherë të mbrohemi kur është fjala për islamin, por duhet të jemi edhe më të zëshëm në demonstrimin e realitetit edhe atë me këmbëngulje kategorike.

Vetë realiteti islam nuk lejon që ne të harxhojmë kohë vetëm për t'u arsyetuar pa nevojë për trillimet, akuzat, shpifjet dhe thashethemet e dexhallëve, klerëve ngatrrestarë, orientalistëve jo muslimanë, marksistëve, laikëve, të shiturëve e kështu me radhë..

Përkundrazi, duhet t'ua zbulojmë atyre dobësitë e mëdha që i kanë, dobësi këto të cilat shpiejnë në humbje dhe nga ana tjetër t'ua tregojmë udhëzimet tona të çmuara.

"Nuk barazohet i verbëri me atë që sheh, e as errësirat me dritën"

Fatir 19-20.

Çdoherë duhet të jemi të gatshëm t'i thërrasin të tjerët në islam me një thirrje që në vete ka kuptim të plotë. E siç dihet detyra e thirrësit është që ai të jetë gjithnjë dashamir i leximit, sepse ALLAHU në Kur'an me zbritjen e fjalës së parë "lexo" dhe me përsëritjen e saj dy herë, na bëri të qartë se jemi popull i leximit.

”Lexo, në emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (do send) krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës).

Lexo, se Zoti yt është më bujari.

Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me laps, i mësoi njeriut atë që nuk e dinte”

El Alak 1-5.

Populli i leximit-libri i të cilëve quhet Kur’an.

Edhe përskaj kësaj mjerisht ky popull nuk lexon.

Muslimanët ishin ata që lexonin derisa shtriheshin në shtratin e vdekjes. Njëri prej tyre pat thënë:

“Fikohem të më kalojë një ditë pa lexuar asgjë”.

Mosha e shtyer nuk ishte aspak pengesë kur bëhej fjalë për kërkimin e diturisë. Kur u shtrohej pyetja se deri kur do të gjurmonin pas diturisë ata përgjigjeshin: “Deri kur të vdesim".

Pa dyshim se ky brez i mbeti besnik këshillës së artë profetike: “Kërkoe diturinë prej djepi gjer në varr”.

Janë pyetur disa të urtë: - A është mirë të mësoj plaku?. Është marrë përgjigjja: “Meqë gabimi i tij (plakut) nuk pëlqehet, mësimi pëlqehet”.

Për fat të keq në kohën e sotme po ndeshemi me një hendek të rëndë, ku leximit nuk i dihet vlera dhe ku libri nuk gëzon respektin e merituar.

Nga ne kërkohet punë e palodhshme që kësaj mbrapshtie t'ia ndërrojmë kahjen dhe popullin ta orientojmë shtigjeve të reja kah libri, ashtu që ai ta japë maksimumin në lexim, e të mos bredhë kot rrugëve për cikërrime që shpiejnë në humbje të sigurt.

Të parët tanë kanë thënë: "Dituria nuk të jep diçka, pa i dhënë ti diçka asaj": Çka do të thotë se duhet t'ia kushtojmë mundësitë, gjithë kohën e edhe jetën diturisë për të fituar diçka prej të vertetës.

"Dhe nuk ju kam dhënë perj diturisë, pos vetëm pak".

El Israë 185

Shtrohet pyetja se a kërkon islami prej nesh vetëm aftësi mendore, ashtu që pas grumbullimit të diturisë së caktuar të tërhiqemi në gjendje statike. Pa kurrfarë dyshimi përgjigjja është se jo.

TË PUNUARIT ME ISLAM – OBLIGIM

Në islam nuk mjafton që muslimani të ketë vetëm dituri, pa fyt; por ky din njëherit kërkon dituri që fryt e ka punën e jo vetëm fjalën dhe llomotitjen e kotë. Thjesht islami kërkon dituri të lidhur thellë me zemrën. Vetëm kjo dituri do ta nxiste zemrën që të punojë më me vrull për dëshirat e pastra.

ALLAHU i gjithëdishëm thotë:

“Me të vërtetë Allahut prej robërve të tij i frikohen dijetarët”.

Fatir 28.

Kjo dituri prodhon frikë ndaj ZOTIT Fuqiplotë.

Muhammedi alejhi selam ka kërkuar mbrojtje prej diturisë së podobishme: “O ZOTI, im më mbroj nga dituria e pavlerë, nga zemra që nuk njeh frikën ndaj Teje, nga puna që nuk ngritet dhe nga lutja që nuk pranohet”.

Omer ibën Hatabi r.a. e luste ALLAHUN që ta mbronte prej dietarëve hipokritë. Ky njëherë u pret: O prijes i muslimanëve. A mund të jetë njeriu dyftyrësh dhe dijetar? Ai dha këtë përgjigje: “Po, dietar me fjalë, e injorant me zemër”.

Dituria mund të ndahet në dysh e shprehur me gojë e jo me zemër-oratori e thatë, e cila do të shërbejë tek ALLAHU si argument që të përgatitet dënimi mertor dhe dituri që rrjedh nga zemra, e cila është e çmuar.

ALLAHU xh.sh. solli në Kur’an dy shembuj më të shëmtuar atë me gomarin dhe me qenin:

Shembulli i atyre, që janë obliguar me tevrat dhe nuk zabtojnë atë, është si shembulli i gomarit që bart libra.

Shembull i keq, është shembulli i popullit që përgënjeshtroi ajet e Allahut, e Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar”

El Xhuma 5.

"Dhe lexoju atyre tergimin e atij që i patëm dhënë dituritë tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi djalli dhe kështu ai u bë prej të humburve".

"E sikur të donim ne, do ta ngrisnim lart me atë dituri, por ai nuk iu largua tokës dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është asi ai i qenit, të cilin nëse e përze, ai sërish e nxjerr gjuhën. Ky shembull është për ata që o i konsideruan gënjeshtra argumentet tona. Ti rrëfe tregimet në mënyrë që ata të mendojnë".

Ela'rafë 175-176.

Shembujt e laartshënuar janë dedikuar për ata që nuk patën lavërdi prej diturisë së tyre.

Muslimani e mëson mënyrën e faljes së namazit dhe e praktikon atë, e mëson frikën ndaj Zotit dhe frikohet, e mëson zekatin dhe e jep atë, e mëson të ndaluarën dhe largohet prej saj si dhe mëson të lejuarën dhe i afrohet asaj. Kjo dituri është e dobishme.

Muslimani i armatosur me njohuri të pastërta islame bëhet shembull për të tjerët, të cilët kur do ta vërenin sjelljen e tij do të thonë: Çfarë bukurie po bburuka prej mësimit islam, sa i bukur qenka rregulli i këtij dini, sa moral të ngritur paska islami…

Ata do të shprehen në këtë mënyrë, sepse do të habiten kur ta shohin me sytë e tyre (dëshmitare) se si duket islami në vepër tek individi e shoqëria.

Në këtë mënyrë u përhap islami në botë e jo përmes fjalimeve. Madje thirrësit e feve tjera. Shumica që ndikuan në përhapjen e islamit anekënd botës ishin njerëz të thjeshtë, zejtarë, tregtarë e kështu me radhë. Psh, në Indonezi dhe vende tjera islami depërtoi përmes tergtarëve. Në

Korenë Jugore islami hyri kohëve të fundit. Që edhe në këtë pjesë të botës të dëgjohet jehona islame, ndikoi sjellja shembullore e ushtarëve turq (muslimanë), të cilët merrnin pjesë në kohën e luftës koreane. Koeranët kur i vërenin turqit se si pastroheshin (abdes: fytyrën, këmbët) dhe rredhiteshin në rreshta u zgjohej kërshëria, çuditeshin pastaj pyetinin:

a) Kush jeni ju?

- "Ne jemi muslimanë", - përgjigjeshin ata.

b) Ç'është islami?

Ushtarët ua sqaronin koreanëve islamin, sipas njohurive me të cilat dispononin ata dhe duke tregtuar shëmbëlltyrë të gjithanshme mundësuan që mijëra koreanë ta pranojnë islamin krahëhapur.

Islami përhapet me sjellje shembullore. Pasqyra e islamit shikohet në praktikimin e tij me përpikëri, kurse dashuria për islam përfitohet atëherë kur shihet islami duke i praktikuar nga njerëzit. Në këtë mënyrë edhe është përhapur islami në fillim.

Nga ana tjetër mori më ogurzi që pengon përhapjen e islamit janë vetë muslimanët. Shikuar në lbira islami është mrekulli e jashtëzakonshme, por kur të tjerët e vërejnë "islamin" tek muslimanët thotnë: "Përse të mos kenë dobi këta (muslimanët) prej këtij (islamit)? dhe Pse nuk vërehet ndikimi i islamit tek jeta e muslimanëve?

Islami thërret në rregull, në program… por mjerisht vendet e muslimanëve janë bërë shembull të anarkisë dhe të destabilitetit. Islami thërret në bashkëpunim, por shtetet e muslimanëve nuk i

përmbahen kësaj dhe janë përçarë. Islami thërret në forcë, e pse muslimanët të jenë të dobët? Islami thërret në dituri e përparim, e nga ana tjetër në shtetet e muslimanëve gjenden akoma tiparet e prapambeturisë dhe analfabetizmit.

Një njeri i perendimit islamin e besoi përmes leximit dhe ishte i flaktë ta shikojë këtë din në vendet ku edhe buroi. Kështu vendosi të shkojë në haxh. Gjatë kryerjes së haxhit vërejti çrregullime, fyerje të ndryshme, etikë të çthurur dhe gjëra të papëlqyeshme nga të cilat u befasua. ALLAHU i Gjithëdijshëm thotë:

"Në haxh nuk lejohet eglendisja me femra sjellja e keqe, fyerja dhe as polemika"

El Bekare 197.

Pra ky njeri i Perendimit vërejti të kundërtën, paramendoi ndryshe, kurse i doli krejtësisht tjetërqysh.

Pas kësaj ai u shprehë me fjalët: "Falënderimi i takon ALLAHUT që më njohu me islamin para se të njihem me muslimanit".

Mu për këtë dijet të bëhemi shëmbëlltyrë e islamit me vepër, gjymyrë e gjallë e trupit të tij dhe Kur'an i komentuar përmes veprës ose ndryshe thënë Kur'an që ec me dy këmbë (njeri me parime kur'anore).

Para së gjithash ne i japim rëndësi punës, moralit dhe sjelljes së mirë. Islami dëshiron prej pjestarit të tij që t'i përmbahet obligimeve të ALLAHUT, t'i largohet gjërave të ndaluara, t'i erspektojë të drejtat e njerëzve tjerë dhe ato të tij. Mirëpo njeriu pikësëpari i ka borxh tipit të tij,

familjes së tij, mysafirëve, vizitorëve, shoqërisë dhe mbi të gjitha ALLAHUT të Gjithëdijshëm. Gjithçka duhet t'i jepet haku që e meriton. Ruajtja e barazpeshës është një çështje me rëndësi të veçantë në jetë. Meqë kjo bën pjesë në parimet islame, muslimanët duhet të kenë kujdes të veçantë, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në drejtimin e sjelljes së tyre.

Sjellja e mirë është frut i kuptimit të drejtë të islamit, ndërsa sjelljet ndryshojnë në përpjestim me individët. Sjellja gradualisht rritet shkallë-shkallë e nuk mbetet në një vend, ashtu siç ngritet nxënësi prej fillores në të mesmen, fakultet… doktoraturë.

Punët dhe veprat e mira ngrisin sjelljen gjithnjë e më tepër. Muslimaani së pari fillon të ndihet i lidhur detyrimisht për farzet, pastaj sunnetet, duke vazhduar gjer në punët vullnetare si falja e namazaev nafile të natës. Kështu ai fillon proporcionalisht të largohet prej gjërave të ndaluara, pastaj nga ato të dyshimtat, duke vazhduar deri në braktisjen e gjërave të papëlqyeshme. E tërë kjo duhet të reultojë drejt një qëllimi të përgjithësuar në rrugën e ALLAHUT Fuqiplotë.

THIRRJA NË ISLAM – OBLIGIM

Obligim i tretë është të thirrurit në islam. Nuk mjafton për muslimanin vetëm të formësohet me qëndrime islame e pastaj të tërhiqet heshtazi anash. Por ky din obligon personin e këtillë që të lëvizë me të gjitha forcat në përpjekje për t'i thirrur edhe të tjerët në rrugën e së cilës kuptojmë se kusht që të shpëtojmë është kështillimi, por edhe pranimi i këshillës.

"Pasha kohën. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm".

El Asr 1-3.

Në islam nuk mjafton vetëm besimi dhe puna e mirë, por patjetër duhet që të këshillohemi e të drejtohemi sipas të vërtetës. Mu për këtë shkak duhet që secili ta bëjë vetveten e tij ushtar në shërbim të rrugës së vërtetë dhe unin e tij ta mësojë me durim dhe dashuri ndaj të së vërtetës.

Këtu qëndron edhe fshehtësia e shprehjes së durimit dhe së të vërtetës aq ngushtë në kaptinën e kohës. Llukmani e këshilloi të birin e tij:

"O biri im, fale namazin, urdhëro në punë të mira e ndalo nga të këqijat dhe përballoju me durim gjërave që të godasin, sepse këto Çështje janë më të preferuara".

Llukman, 17.

Durimi është i patjetërsueshëm, sepse thirrja islame është e rëndë e veçmas në kohën e sotme. Për këtë ALLAHU i Gjithëdijshëm i tha të dërguarit të Tij qysh në fillim të miskonit:

"Ne do të ngarkojmë me fjalë të rëndë".

Muzzemmil, 5.

Thirrja është fjalë e rëndë (me peshë) dhe ngarkim i madh, kurse ne jemi trashëgues të kësaj barre. Sot gjendemi në kohën kur vazhdimisht shtohen vështirësitë, si pasojë e braktisjes së fasë nga ana e njerëzve, të cilëve u mungon besimi e u shtohet oreksi për këtë jetë e mosinteresimi

total për jetën tjetër, rrjedhshmëria e së cilës sjell pengesa të shumta për gjërat e mira e lehtësime për ato të këqijat.

Thirrësi do të has para vetes në pengesa, bile edhe në shtëpinë e tij, ndofta prej babait, vëllait ose prej miqve më të afërt të tij. Ata sigurisht se do t'i thonë:

- "Çka ke ti me këtë, a do që tç dënohesh apo që të persekutohesh?…

Gjithnjë e më i pranishëm është ëfakti se femra përqeshet nëse e vë petkun e mbulesës dhe shndërrohet në objekt loje. Sa për ilustrim dëshmon edhe një rast, i cili vlen të ceket.

Një femër e cila e kishte vënë petkun e mbulesës, më vonë qe e detyruar ta heq atë e të vesh petk të shkurtër. Siç u kuptua më vonë pengesë e saj ishte familja dhe të afërmit. Ata talleshin me mbulesën islame. Muslimanja e cila ka besim të vërtetë nuk duhet të thyhet përballë këtyre stuhive, por nga ato duhet të motivohet për qëndrueshmëri. Fatkeqësisht besimi i saj i dobët e bëri të kundërtën.

Gjithashtu edhe në kohën e sotme hasim në pengesa të shumta. Muhammedi alejhi selam i vetëdijshëm për ardhjen e kësaj kohe pat thënë: "Ai që i përmbahet fasë së tij (do ta ketë vështirë) sikur ta mbajë gacën në duar".

Nisur nga ky fakt duhet të mbështetemi sa m ëfortë në parimet islame dhe t'i thërrasim edhe të tjerët edhe pse ndoshta do të ndeshemi me kundërshtime, si në familje, shoqëri e gjetiu. Ne vështirësive duhet t'u bëjmë ballë, sepse çdo thirrje ka edhe rrezistencën e tij.

"Secilit pejgamber i bëmë armiqë prej xhinëve dhe njerëzve…"

El Enamë, 112

“Secilit pejgamber i bëmë armiqë e kriminela prej jobesimtarëve”.

El Furkanë, 31.

Kuptohet se Ai që e krijoi Ademin e krijoi edhe Iblisin; AI i Cili e krijoi Ibrahimin e krijoi edhe Nemrudin, ai që e krijoi Musain e krijoi edhe Firaonin dhe Ai i Cili e krijoi Muhammedin alejhi selam e krijoi edhe Ebu Xhehlin.

Në çdo kohë ka Nemruda, Firaona dhe Ebu Xhehla. Emrat ndërrohen, por mendjet dhe zemrat janë të një qëllimi.

Koha e sotme është kohë ideologjish. Komunizmi me klasikët e vet, jehudizmi me strategët e tij, masonizmi me thirrësat e tij, krishterizmi, behaizmi, kadianizmi…

Çdo orientim i ka thirrësat e tij. Po islami?…Vallë a nuk duhet t’i ketë ky din thirrësat dhe ndihmuesit e tij?…

Islami me natyrshmrinë që ka, thërret në përhapje sa më të gjerë. ALLAHU i GJithëdishëm thotë:

“A ka fjalë më të mrë se ajo e atij që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: “unë jam perj muslimanëve”.

Fussilet 33.

Mu për këtë obligimi i të rinjëve në kohën e sotme është që të përgatiten për të thirrur në rrugën e ALLAHUT – Krijuesit tonë. Nuk ka obligim më të madh se ky, sepse është obligim i të dërguarëve, të cilët e transmetuan islamin qartë e drejtë. Ai që thirr duhet të mundohet të jetë pasqyrë në atë që thërret, ashtu që islamin ta kuptojë e ta jetojë ashtu siç duhet.

LIDHSHMËRIA ME ISLAMIN – OBLIGIM

Të rinjtë, të cilët vendosën ta kuptojnë islamin drejt me një besim të thellë dhe të patundur, si dhe u zotuan se do të këshillohen sipas parimeve të tij, patjetër duhen të këshillohen, ngase nuk ka punë vetjake në islam. Pra çështje kryesore për ne duhet të jetë veprimtaria e përbashkët, e cila do të krijonte mes nesh një lidhje të fortë vëllazërore, themelet e së cilës do të ndërtoheshin në dashurinë e ndërsjellë për ALLAHUN-Krijuesin e kozmosit të pafund.

Të vizitohemi, të bisedojmë për çështjet e përbashkëta që na preokupojnë vetëm e vetëm për hir të kësaj kauze, ndonëse kemi xhematë të ndryshëm. Pa këtë metodologji të punës nuk mund të arrijmë asgjë, sepse vetëm me një dorë nuk duatrokitet.

"Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoheni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë".

El Enfajë, 73

Muslimanët duhet të ndihmohen, të shoqërohen dhe të lidhen mes veti, ashtu që të mos lejohet bashkimi në anën e njerëzve të humbur. Nëse i hapim shteg përçarjes, shpifja dhe trazira do të jetë e madhe.

Këto katër obligime duhet t'i kuptojmë mirë dhe t'i vërejmë pikësëpari tek vetvetja se si e sa i kemi në rregull. Të rinjtë muslimanë duhet ta dinë obligimin e tyre në kohën e sotme. Ata duhet të përfitojnë prej historisë së tyre të lavdishm, faqet e së cilës janë të mbushura me fitore, suskese dhe të aritura kolosale.

Kështu do të jetë nëse ecim me udhëzimet islame: islami program i jetës sonë. Dhe kjo një ditë do të vie.

"Atë ditë gëzohen esimtarët për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe ai është i gjithëfuqishëm, mëshirues. premtim i ALlahut është ky, Allahut nuk e then premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk po e dinë"

Er Rrum, 4-6.

Për fund lutja jonë do të jetë:

"Falënderimi i takon Allahut – Zotit të botërave"